



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR VJOSË

Nr 16/12 Prot

Vlorë, më 24 . 10 . 2022.

VENDIM

Nr. 13 , datë 14.10.2022

PËR

**MIRATIMIN E KËRKESËS PËR LEJE PËR KRYERJE SHPIMI NËNTOKËSOR PËR
NXJERRJE UJI (PUS-SHPIMI), ME VENDNDODHJE, GËRHOTË, BASHKIA
GJIROKASTËR, QARKU GJIROKASTËR**

Në mbështetje të shkronjës “b” të pikës 2, të nenit 41, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.550, datë 15.07.2020, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim për dhënien me koncension të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujrave të pëdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimarrjes, të formateve të lejes, të autorizimit, të kushteve të posaçme dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Ujor Vjosë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje për kryerje shpimi nëntokësor për nxjerrje uji (pus-shpimi), me vendndodhje: Gërhotë, Bashkia Gjirokastër, Qarku Gjirokastër të z.Besnik Skënduli.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Akuiferi që kërkohet të shfrytëzohet: Akuiferi ndërkokrrizor i Drinosit. Ky akuifer përfaqëson një depresion të mbushur me depozitime Kuaternare kryesisht zhavorre, zhure dhe rëra, produkt i materialit të ngurtë aluvial që ka sjellë lumi i Drinosit.

Koordinatat e vendndodhjes së shpimit (KRGJSH)

X 511276.1841 — Y 4440383.0988 — Z 193 m.m.n.d

Qëllimi i përdorimit të ujit: Uji që do të merret nga pusi do të përdoret për vaditje të bimësisë.

Prurja e ujit të kërkuar: $Q=1.5$ l/sek

Thellësia e pus-shpimit: 55 m

Diametri pus-shpimit = $\varnothing 250$ mm , thellësia nga 0 deri në 55 m

Lloji i shpimit: Shpim në shtresë me presion (Akuifer me porozitet ndërkokrrizor dhe ujëpërcjellshmëri të ulët-shumë të ulët) .

Thellësia e vendosjes së pompës : 40m

3.Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.



KRYETAR

FLAMUR MAMAJ